



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 94 Prot.

Tiranë, 17 10 2023

Lënda: Dhënie informacioni në lidhje me procesin e aplikimeve për anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së nga rradhët e avokatëve dhe nga shoqëria civile

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit

Për dijeni Znj. Klotilda BUSHKA
Kryetare e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Z. Genci GJONÇAJ
Sekretari i Përgjithshëm

Kuvendi i Shqipërisë
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
TIRANË

E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit,

Në vijim të publikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të shpalljes së vendeve vakante dhe thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe nga shoqëria civile, lutemi gjeni bashkëlidhur një informacion të përmbledhur në lidhje me ecurinë e deritanishme të këtij procesi.

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Fatbardh Zencaj



INFORMACION

NË LIDHJE ME PROCESIN E DERITANISHËM TË APLIKIMEVE PËR ANËTARË TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA AVOKATIA DHE SHOQËRIA CIVILE SI DHE PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË SHOQËRISË CIVILE QË DO TË KRYEJNË VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATURAVE PËR ANËTARIN QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR DHE NË KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vijim të publikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, të shpalljes së vendeve vakante dhe thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe nga shoqëria civile, Avokati i Popullit nisi menjëherë punën për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të nevojshme administrative për zhvillimin e procesit, në përputhje me kompetencat dhe afatet e percaktuara në ligjin e sipërcituar.

Fillimisht, Avokati i Popullit publikoi dhe në faqen e tij zyrtare, shpalljen e vendeve vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit, sipas lidhjeve përkatëse në faqen zyrtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në vijim, me urdhrin, nr.113, datë 24.07.2023, të Avokatit të Popullit u krijua grupi ad hoc i punës për mbështetjen e Avokatit të Popullit në ushtrimin e kompetencave ligjore, për plotësimin e vakancave për anëtarë në Këshillin e Lartë Gjyqësor si dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve dhe nga shoqëria civile.

Grupi i Punës, i cili do të shërbejë dhe si Sekretariat teknik për Komisionin e Pavarur Ad Hoc deri në përfundimin e gjithë procesit, nisi menjëherë punën për realizimin e detyrave që lidheshin me marrjen në dorëzim të shprehjes së interesit, verifikimin paraprak të plotësimin të kushteve ligjore, njoftimin e kandidatëve për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë si dhe rregjistrimin dhe protokollimin e tyre sipas ligjit.

Sipas thirrjes së shprehjes së interesit, afati i fundit i dorëzimit të aplikimeve ishte data 5 gusht 2023, por duke qenë se data e fundit e aplikimit ishte ditë pushimi zyrtar (dite e shtunë), në

përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, afati i fundit mbaroi në ditën e punës që erdhi pas saj (ditën e hënë, më datë 7 gusht 2023, ora 16.30).

Në përfundim të afatit të aplikimit për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga avokatia dhe shoqëria civile si dhe për anëtarë të komisionit të shoqërisë civile që do të kryejnë verifikimin paraprak të kandidaturave për anëtarin që përfaqëson shoqërinë civile në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Avokati i Popullit publikoi listën e kandidatëve/organizatave aplikues nga ku rezultoi si më poshtë:

- ✚ 28 kandidatë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga avokatia
- ✚ 22 kandidatë për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga avokatia
- ✚ 12 kandidatë¹ për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga shoqëria civile
- ✚ 11 kandidatë² për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga shoqëria civile
- ✚ 7 organizata të shoqërisë civile për anëtarë të komisionit të shoqërisë civile

Gjatë gjithë kësaj periudhe, Grupi i Punës pas vlerësimit të dokumentacionit të çdo kandidati nga rradhët e avokatisë apo shoqërisë civile, kur ky dokumentacion nuk ka qenë i plotë për të vlerësuar plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në Kushtetutë dhe në nenin 19, të këtij ligji të sipërcituar, si dhe të kriterëve profesionale e morale, sipas nenit 34, të këtij ligji, i ka kërkuar kandidatëve të bëjnë plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumenteve shtesë brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Sigurisht që mosparaqitja në ndonjë rast e dokumentacionit plotësues, ose dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 5-ditor, nuk e ka pezulluar procesin e regjistrimit përfundimtar të kandidatëve dhe të dokumentacionit shoqëruës.

Grupi i Punës, pas përfundimit të afatit të shprehjes së interesit nga Organizatat e Shoqërisë Civile për anëtar të komisionit të shoqërisë civile që do të kryejnë verifikimin paraprak të kandidaturave për anëtarin që përfaqëson shoqërinë civile në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ka nisur procesin e verifikimit të plotësimit të kriterëve nga Organizatat që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile. Duhet të theksohet se afati i fundit i përcaktuar për dorëzimin e shprehjes së interesit ishte data 03.08.2023, por për shkak të numrit të pamjaftueshëm të organizatave që shprehën interesin e tyre për anëtar të komisionit të shoqërisë civile, Avokati i Popullit rishpalli thirrjen e interesit duke përcaktuar datën 07.08.2023 si afatin e fundit të dërgimit të shprehjes së interesit.

Avokati i Popullit do të bëjë shumë shpejt publike listën e Organizatave të Shoqërisë Civile që plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e komisionit të verifikimit paraprak të shoqërisë civile.

Gjithashtu, në përputhje me nenin 23 dhe 25 të ligjit të sipërcituar, pas kërkesës së Avokatit të Popullit, në kuadër të procedurave për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidateve për anëtarë të Këshillit të lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë, Dhoma e Avokatisë komunikoi listën e avokatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore për anëtar dhe anëtar zëvendësues në Komisionin e Pavarur Ad Hoc.

¹ Një kandidat u tërhoq më pas nga aplikimi.

² Një kandidat u tërhoq më pas nga aplikimi.

Avokati i Popullit pas shqyrtimit të listës së avokatëve ftoi më të riun në moshë dhe më të vjetrin në moshë ndër ta që të shërbejnë si anëtarë të Komisionit të Pavarur Ad Hoc. E njëjta procedurë dhe në bazë të të njëjtit kriter u ndoq dhe në rastin e caktimit të dy anëtarëve zëvendësues.

Duhet të informojmë se në rastin e caktimit të anëtarit më të vjetër në moshë, kandidati i parë për arsye personale nuk pranoi të shërbente si anëtar dhe, për rrjedhojë, u vazhdua me kandidatin që pasonte në listë, sipas kriterit të moshës.

Në përfundim të procedurave të mësipërme, Avokati i Popullit bëri publike emrat për anëtarë dhe anëtarë zëvendësues nga rradhët e avokatëve në Komisionin e Pavarur Ad Hoc, si më poshtë:

- ✓ Maksim Haxhia – anëtar
- ✓ Ilir Dode - anëtar
- ✓ Sokol Puto – anëtar zëvendësues
- ✓ Erajd Dobjani- anëtar zëvendësues

E njëjta procedurë u ndoq edhe në rastin e plotësimit të vendit të anëtarit të Komisionin e Pavarur Ad Hoc nga Akademia e Shkencave ku pas kërkesës zyrtare të bërë nga Avokati i Popullit, me shkresë zyrtare Akademia e Shkencave komunikoi emrat e anëtarit dhe anëtarit zëvendësues për Komisionin e Pavarur Ad Hoc si më poshte:

- ✓ Akademik Shaban Sinani- anëtar
- ✓ Akademik i asocuar Adrian Civici – anëtar zëvendësues

Gjithashtu, në kuadër të verifikimit të kushteve ligjore, vlerësimit paraprak të kriterëve profesionale dhe morale dhe renditjen e avokatëve që kandidojnë për të qenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Avokati i Popullit në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Pavarur Ad Hoc, i dërgoi zyrtarisht Prokurorisë së Përgjithshme kërkesën për verifikimin e formularëve të deklarimit.

Kjo kërkesë bazohet në pikën 2 të nenit 31 dhe pikës 2 të nenit 129, ku përcaktohet se: "*Për kontrollin e integritetit të kandidatëve, kryetari i Komisionit i përcjell menjëherë Prokurorisë së Përgjithshme, formularët e vetëdeklarimit, të plotësuar nga kandidatët, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Prokuroria e Përgjithshme, kryen verifikimet brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve*".

Në zbatim të pikës 3 të nenit 31 dhe pikës 3 të nenit 129, ku përcaktohet se: "*Për kontrollin e kushteve të tjera ligjore, kryetari i Komisionit dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës*", Avokati i Popullit i dërgoi, gjithashtu, një shkresë zyrtare Autoritetit për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit ku kërkohet verifikimi i kandidatëve, mbi bazën e listës së emrave që kanë aplikuar nga rradhët e avokatisë për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nëse kanë qenë ose jo anëtarë, bashkëpunorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut të vitit 1991.

Për shkak të rëndësise që ka ky proces verifikimi, në kuadër të vlerësimit të kriterëve morale të kandidatëve, **Avokati i Popullit do të kërkonte ndërhyrjen e Kuvendit të Shqipërisë pranë këtyre institucioneve për t'i rikujtuar rëndësinë që ka kryerja me prioritet e verifikimeve**

përkatëse, sipas dispozitave të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Avokati i Popullit ka zhvilluar takime me përfaqësues të delegacionit të Bashkimit Evropian si dhe të misionit të OPDAT-it në Tiranë me qëllim ndjekjen, monitorimin dhe mbështetjen nga afër të këtij procesi në të gjitha fazat e tij nga këto organizma duke pasur parasysh rolin qendror të tyre në progresin e vazhdueshëm të reformës në drejtësi.

Në kuadër të këtij informimi, do të donim që t’ju bënim të ditur gjithashtu se në zbatim të pikës 6, të nenit 34 të ligjit të sipërcituar, është duke u hartuar dhe projekt-rregullorja për funksionimin e Komisionit të Pavarur *Ad hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve që do të përcaktojnë rregulla për detajimin e mëtejshëm të kriterëve dhe për caktimin e peshës specifike të tyre në renditjen e kandidatëve.

Projekt-rregullorja do të miratohet në mbledhjen e parë të Komisionit, mbledhje e cila është parashikuar të zhvillohet më datë 24.08.2023, dhe do të publikohet menjëherë në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit. Projekt-rregullorja do t’i dërgohet paraprakisht për mendim edhe organizmave ndërkombëtarë të përmendur më sipër.

Së fundmi, në kuadër të transparencës dhe informimit të publikut në lidhje me të gjitha fazat e zhvillimit të këtij procesi, në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit janë çelur dy rubrika të veçanta të cilat në mënyrë të vazhdueshme përditësohen me informacione dhe njoftime për shtyp në lidhje me këtë proces. Për më shumë informacion, mund të referoheni në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article-ildp-layout/transparency>.